



Departamenti 6

Dërgesë nga komuna e vendbanimit kryesor

**Për të gjithë prindërit, fëmijët e të cilëve kanë lindur
në periudhën prej
1.9.2008 deri më 31.8.2009**

GZ: ABT06-

Ref: **Viti i detyrueshëm për përkujdesje të fëmijëve
2014/2015**

→ Bildung und Gesellschaft

Departamenti

Arsimimi dhe kujdesi ndaj fëmijëve

Zyrtari përgjegjës: Znj. Mag.

Draschbacher

Tel.: (0316) 877- 3684

Fax: (0316) 877- 2136

E-Mail: kin@stmk.gv.at

Në shkresë përgjigje e shënoni ju
lutemi numrin e referencës (GZ)

Graz, më 11 tetor 2013

Të nderuar prindër/Të nderuar kujdestarë ligjorë!

Që nga viti 2010/2011 në Shtajermark para fillimit të shkollimit të detyrueshëm ka startuar viti i detyrueshëm për përkujdesje të fëmijëve për fëmijët që ndodhen në vitin e fundit për përkujdesje (viti parashkollor).

Për vitin për përkujdesje të fëmijëve 2014/2015 qysh tani ju ofrojmë informacionin e mëposhtëm:

Detyrimet e prindërve

- **Të gjithë prindërit, fëmijët e të cilëve janë lindur në periudhën prej 1.9.2008 deri më 31.8.2009, janë të detyruar, që deri më 30 prill 2014 ta njoftojnë komunën e vendbanimit kryesor të fëmijës, se cilin institucion për përkujdesje të fëmijëve do ta ndjekë fëmija i tyre në vitin për përkujdesje të fëmijëve 2014/2015.**

Prindërit janë të lirë të zgjedhin se cilin institucion do ta ndjekë fëmija i tyre. Edhe në qoftë se fëmija tashmë e ndjek një institucion për përkujdesje të fëmijëve, ju duhet ta bëni njoftimin në fjalë. Nuk kërkohet ta bëni këtë njoftim, vetëm në rast se fëmija do ta ndjekë një institucion të komunës së vendbanimit kryesor, p.sh. kopshtin e komunës së vendbanimit. Në rast se fëmija e ndjek një institucion privat për përkujdesje të fëmijëve, atëherë gjithsesi duhet ta njoftoni komunën ku banoni. Prindërit mund ta parashatrojnë, jo më vonë se deri më 30 prill 2014, në komunën ku banojnë një kërkesë që komuna t'ia caktojë një vend fëmijës së tyre.

Vini re – rast i veçantë - Graz:

Për shkaqe organizative për përkujdesjen e fëmijëve në Graz vlejnë rregullat e mëposhtme:

- Prindërit, fëmijët e të cilëve vendbanimin kryesor e kanë në Graz dhe e ndjekin një institucion për përkujdesje të fëmijëve në Graz (si privat ashtu edhe publik), nuk nevojitet të lajmërohen askund, sepse këta fëmijë janë të regjistruar në një regjistrë qendror.
 - Prindërit, fëmijët e të cilëve vendbanimin kryesor e kanë në Graz dhe e ndjekin një institucion për përkujdesje të fëmijëve jashtë Graz-it, duhet ta bëjnë patjetër lajmërimin e fëmijës në Departamentin për Arsimit dhe Integrim të qytetit të Graz-it, (Abteilung für Bildung und Integration der Stadt Graz, dein Graz – Plattform für Kinderbildung und –betreuung), Keesgasse 6, 8011 Graz, Angelika Lichtenberg, Tel.: 0316/872-7442, Email: angelika.lichtenberg@stadt.graz.at.
- Në kuadër të vitit të detyrueshëm për përkujdesje të fëmijëve prindërit (kujdestarët ligjorë) janë të detyruar të kujdesen, që fëmija i tyre, i cili e ka vendbanimin kryesor në Shtajermark, në vitin e detyrueshëm për përkujdesje të fëmijëve, të ndjekë një institucion përkatës të përkujdesit të fëmijëve në përshtatje me moshën e tij (kopsht i fëmijëve, grup për mosha të ndryshme, shtëpi fëmijësh) pesë ditë në javë dhe të paktën me orar gjysmëditor.
 - **Kohët përjashtuese - Fëmijët duhet të shkojnë në institucionin përkatës përveç:**
 - a. Gjatë festave dhe kur nuk mbahet mësim
 - b. Kur fëmija mungon me arsye: Mungesë e arsyeshme është pushimi vjetor (më së shumti tri javë), kur sëmuret fëmija ose prindërit (kujdestarët ligjorë) si dhe në raste të jashtëzakonshme.
Prindërit (kujdestarët ligjorë) duhet ta njoftojnë menjëherë institucionin në rast se fëmija mungon. Nëse ekzistojnë dyshime konkrete në lidhje me sëmundjen e fëmijës, bartësi/bartësja e institucionit mund të kërkojë nga prindërit (kujdestarët ligjorë) një vërtetim mjekësor. Pas tri javësh mungese duhet ta sillni patjetër një vërtetim mjekësor.

Rregullat në lidhje me kohët përjashtuese vlejnë analogjikisht edhe për fëmijët të cilët e ndjekin vitin e detyrueshëm për përkujdesje të një kujdestare ditore/kujdestarë ditore. Në këtë rast vërtetimet mjekësore duhet t'i dorëzoni te kujdestarja përkatëse ditore/kujdestari përkatës ditore ose te punëdhënësjë e saj/e tij, gjegjësisht te punëdhënësi i saj/i tij.

- **Rastet e veçanta:**

- a) **Regjistrimi i parakohshëm në shkollë:** Kjo arsye e veçantë duhet të paraqitet prej prindërve, **më së voni deri më 30 prill 2014**, te komuna e vendbanimit kryesor të fëmijës (vlen edhe për fëmijët e Graz-it, kompetent është: Departamenti për Arsimit dhe Integrim i qytetit të Graz-it, (Abteilung für Bildung und Integration der Stadt Graz, dein Graz – Plattform für Kinderbildung und -betreuung) – shih më lart). Njoftimit duhet t'ia bashkangjitni vërtetimin përkatës të shkollës.
- b) **Fëmijët, për të cilët, për shkak të aftësive të kufizuara, për arsye mjekësore ose për shkak të largësisë së institucionit nga vendbanimi i tyre ose për shkak të kushteve të vështira rrugore, ndjekja e mësimin në institucionin e përkujdesjes do të paraqiste ngarkesë të paarsyeshme (për fëmijën):**
Në këto raste, **jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2013**, duhet t'ia parashtroni një kërkesë me arsyetimin përkatës administratës së qarkut që është kompetente për komunën e vendbanimit kryesor të fëmijës, ndërsa në rastet e aftësisë së kufizuar ose në rastet për arsye mjekësore kërkesës duhet t'ia bashkangjitni për shembull një ekspertizë nga mjeku specialist. Kërkesa duhet të parashtrohet në komunën e vendbanimit kryesor të fëmijës, e

8010 Graz • Karmeliterplatz 2

Wir sind Montag bis Freitag von 8:00 bis 12:30 Uhr und nach telefonischer Vereinbarung für Sie erreichbar
Öffentliche Verkehrsmittel: Bus Linie 30, Haltestelle Karmeliterplatz
DVR 0087122 • UID ATU37001007 • Landes-Hypothekebank Steiermark: BLZ: 56000, Kto.Nr.: 20141005201
IBAN AT375600020141005201 • BIC HYSTAT2G

cila pastaj duhet ta përcjellë kërkesën menjëherë te administrata kompetente e qarkut, sepse afati për marrjen e vendimit fillon me depozitimin e kërkesës. Administrata e qarkut duhet të konstatojë përmes një vendimi nëse ekziston njëri nga kushtet përjashtues dhe duhet ta njoftojë edhe komunën e vendbanimit kryesor të fëmijës lidhur me vendimin në fjalë.

- c) **Përkujdesja vetëm te kujdestarja ditore/kujdestari ditor (Tagesmutter/Tagesvater):** Kjo arsye e veçantë duhet të paraqitet prej prindërve, **jo më vonë se deri më 30 prill 2014**, te komuna e vendbanimit kryesor të fëmijës (vlen edhe për fëmijët e Graz-it, kompetent është: Departamenti për Arsimim dhe Integrim i qytetit së Graz-it, (Abteilung für Bildung und Integration der Stadt Graz, dein Graz – Plattform für Kinderbildung und -betreuung) – shih më lart). Për të përmbushur detyrimin për ndjekjen e mësimin, orari i përkujdesjes te kujdestarja ditore/kujdestari ditor duhet t'ia përmbajë të paktën 20 orë në javë. Kërkesës duhet t'ia bashkangjitni vërtetimin përkatës të punëdhënësës të kujdestares ditore/të kujdestarit ditor gjegjësisht punëdhënësit të kujdestares ditore/të kujdestarit ditor.

Vini re: Viti i detyrueshëm për përkujdesje të fëmijës në rast të përkujdesjes nga ana e një kujdestareje ditore/kujdestari ditor nuk është pa pagesë siç është zakonisht për gjysmën e ditës në një institucion shtetëror.

- d) **Përkujdesja në kuadër të edukimit shtëpiak:**

Në këto raste, **jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2013**, duhet t'ia paraqitni kërkesën administratës së qarkut që është kompetente për komunën e vendbanimit kryesor të fëmijës dhe ta bëni të qartë në mënyrë të besueshme se detyrat arsimore do të zbatohen në mënyrë adekuate në shtëpi. Kërkesa duhet të parashtrohet në komunën e vendbanimit kryesor të fëmijës, e cila pastaj duhet ta përcjellë kërkesën menjëherë te administrata kompetente e qarkut, sepse afati për marrjen e vendimit fillon me depozitimin e kërkesës. Administrata e qarkut duhet të konstatojë përmes një vendimi nëse ekziston njëri nga kushtet përjashtues dhe duhet ta njoftojë edhe komunën e vendbanimit kryesor të fëmijës lidhur me vendimin në fjalë.

Të gjitha informacionet në lidhje me vitin e detyrueshëm për përkujdesje të fëmijëve mund t'ia gjeni edhe në internet në faqen www.kinderbetreuung.steiermark.at. Atje mund ta gjeni gjithashtu edhe **formularin mostër për lajmërim në komunën e vendbanimit kryesor**.

Sinqerisht juaji
Për Qeverinë e Landit të Shtajermarkut:
Udhëheqësi i Departamentit:
përfaqësuesi:

Mag. Franz Schober

Bashkëngjitur:

Formulari mostër për lajmërim në komunën e vendbanimit kryesor